



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVES-VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E SHENDETESISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	02
Nr. Prot. Broj Prot Prot. No.	05-8072
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	- 21 -
Data: Datum: Date:	21/10/2024
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva- Ministry of Health

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Ured Generalnog Sekretara -Office of the General Secretary

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	RTM 03/2024				
PËR/ZA/TO:	Dr. Arben Vitia, Ministër i Shëndetësisë				
CC:	Të gjithë Udhëheqësve të Departamenteve				
NGA/OD/FROM:	Dr. Naim Bardiqi, Sekretar i Përgjithshëm				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raport i tremujorit të tretë të vitit 2024				
Nr. i zyrës:	116	Lokacioni:	Prishtinë	Data:	
Br. kancelarije:		Kucni:		Datum:	18.10.2024
Room No.:		Extension:		Date:	
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					<input type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					<input type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS					<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZEMO RASPRAVLJATI/MAY WE DISCUSS					<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION					<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED					<input type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED					<input checked="" type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN					<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					<input checked="" type="checkbox"/>

I nderuar Ministër, Dr. Arben Vitia,

Të bashkëlidhur gjeni raportin e tremujorit të tretë të vitit 2024, të Ministrisë së Shëndetësisë.

Me respekt,



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo Zdravstva - Ministry of Health
Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm/ Ured Generalnog Sekretara/ Office of the Secretary General

RAPORTI I TREMUJORIT TË TRETË
2024
MINISTRIA E SHËNDETËSISË

Prishtinë, Tetor 2024

Përmbajtja

Shkurtesat _____	II
1. Përmbledhje ekzekutive _____	1
2. Ruajtja dhe përparimi i shëndetit _____	5
2.1 Shëndeti publik _____	5
3. Progresi me planin e punës – rezultatet e indikatorëve kyç të performancës _____	6
3.1. Hartimi i strategjive dhe politikave _____	6
3.2. Zbatimi i programit dhe planit legjislativ _____	6
3.3. Hartimi i udhërrëfyeseve dhe protokolleve klinike _____	7
3.4. Zbatimi i planeve kombëtare për zhvillim dhe integrim evropian _____	8
3.5. Kujdesi parësor shëndetësor _____	9
3.6. Furnizimi me barna për KPSH _____	10
3.7. Asistenca teknike dhe marrëveshjet financiare _____	10
3.8. Shërbimet shëndetësore _____	11
3.9. Komunikimi me publikun _____	12
3.10. Zhvillimi i sistemit të informimit shëndetësor _____	13
3.11. Inspektimet _____	14
3.12 Pajisjet dhe produktet mjekësore _____	14
4. Pasqyra e performancës financiare _____	15
4.1. Shpenzimet kapitale dhe projektet _____	15
5. Zbatimi i rekomandimeve të ZKA dhe NJAB _____	16
5.1. Zbatimi i rekomandimeve të Zyrës kombëtare të auditimit për PVF 2022 _____	16
5.2. Zbatimi i rekomandimeve të Zyrës së Avokatit të popullit _____	16
6. Planet për tremujorin e ardhshëm _____	17
7. Sfidat _____	17

Shkurtesat

AQH	Accesible quality healthcare
AIP	Agjencia për informim dhe privatësi
ARC	Agjencia e regjistrimit civil
ASHI	Agjencia e shoqërisë së informacionit
AUV	Agjencia e ushqimit dhe veterinës
BQShS	Bordi qendror për shkollim specialistik
IKShPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
IPSh	Institucionet private shëndetësore
ISh	Institucion shëndetësor
ISSh	Instituti special Shtime
IAP	Institucioni i avokatit të popullit
KPSh	Kujdesi parësor shëndetësor
KDSh	Kujdesi dytësor shëndetësor
KKUPK	Këshilli Kosovar për udhërrëfyes dhe protokolle klinike
LBE	Lista e barnave esenciale
MSh	Ministria e Shëndetësisë
NJHKEK	Njësia për hetimin e krimeve ekonomike
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OPSh	Odat e profesionistëve shëndetësorë
OPPK	Oda e përmbauesve privat të Kosovës
OShP	Organi shqyrtues i prokurimit
OJQ	Organizatë jo qeveritare
PSO	Procedura standarde operative
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QKMF	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
QRSHP	Qendra rajonale e shëndetit publik
QMF	Qendra e Mjekësisë Familjare
SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës
SP	Spital i përgjithshëm
SISh	Sistemi i informimit shëndetësor
SMSF	Sistemi i menaxhimit të stokut farmaceutik
SIMBNj	Sistemi Informativ i menaxhimit të burimeve njerëzore
SIMFK	Sistemi i menaxhimit të pasurisë kapitale
UPK	Udhërrëfyes dhe protokolle klinike
ZSP	Zyra e Sekretarit të përgjithshëm
ZKA	Zyra kombëtare e auditimit
ZKF	Zyrtar kryesor financiar
ZKM	Zyra e kryeministrit

1. Përmbledhje ekzekutive

Ministria e Shëndetësisë në tremujorin e tretë të vitit 2024 ka vazhduar angazhimin në hartimin dhe finalizimin e politikave dhe zbatimin e ligjeve mbi bazën e një sistemi jo diskriminues dhe të përgjegjshëm për kujdesin shëndetësor të bazuara në analiza profesionale dhe të dhëna shkencore. Gjatë kësaj periudhe janë përcaktuar norma dhe standarde për sektorin e shëndetësisë, duke i respektuar standardet përkatëse ndërkombëtare si dhe janë ndërmarr të gjitha masat e përcaktuara me ligj për realizimin e veprimeve të duhura me qëllim të zbatimit dhe mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve, banorëve dhe shfrytëzuesve të tjerë të shërbimeve shëndetësore, në kujdesin shëndetësor.

Në kuadër të ruajtjes së shëndetit publik, është zhvilluar mbikëqyrja dhe përcjellja e situatës epidemiologjike. Sa i përket virusit “*West Nile*” është bërë testimi për rastet e dyshimta, konfirmimi laboratorik dhe raportimi i rasteve pozitive. Janë grumbulluar analizat e rezultateve të ujit për pije, ku të gjitha mostrat rezultojnë brenda standardeve të parapara për ujin e pijes sipas UA 16/2021 për cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor. Gjatë periudhës raportuese është përcjellë dhe monitoruar ndikimi i toksinave kimike dhe mikrobiologjike me origjinë nga ushqimi, pesticidet në ujë, metalet e rënda, mineraleve, në ujërat e pijshëm dhe rekreativ dhe ndikimi i tyre në shëndetin e popullatës. Sa i përket statistikave shëndetësore janë përgatitur të dhënat për dhjetë diagnoza më të shpeshta nga viti 2012 -2022 (nga të gjitha diagnozat) të morbiditetit të raportuara nga institucionet shëndetësore publike të tre niveleve të kujdesit shëndetësor.

Sa i përket hartimit të planeve strategjike dhe planeve të veprimit në tremujorin e tretë, është finalizuar Strategjia sektoriale shëndetësore 2025-2030 dhe është publikuar në platformën për konsultime publike.

Ministria me qëllim të adresimit të rreziqeve të sigurisë shëndetësore ka miratuar Planin e veprimit për siguri shëndetësore 2024-2026 që siguron se kapacitetet kombëtare për parandalim, gatishmëri, reagim dhe rimëkëmbje të emergjencave shëndetësore të janë të planifikuara, krijuara, fuqizuara dhe të kenë qëndrueshmëri në mënyrë që të arrihet siguria shëndetësore kombëtare, regjionale dhe globale.

Përgjatë kësaj periudhe po ashtu janë miratuar plane strategjike që synojnë të zhvillojnë fusha të rëndësishme të shëndeti publik sikurse skringu neonatal, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, zhvillimi i kapaciteteve laboratorike dhe fuqizimi i kapaciteteve të emergjencave. Gjatë periudhës raportuese janë hartuar dhe aprovuar plane të veprimit në zbatim të kornizës ligjore dhe të standardeve në fuqi. Sa i përket hartimit të standardeve dhe praktikave të mira shëndetësore, përmes hartimit të udhërrëfyesve klinik, dhe protokollove klinikë në këtë periudhë është vazhduar me hartimin dhe finalizimin e gjashtëdhjetë udhërrëfyesve klinik dhe tri protokolleve klinike.

Në zbatim të Programit dhe të planit legjislativ, ka vazhduar monitorimi i procesit të hartimit të legjislativ. Në tre muajorin e tretë të këtij viti janë finalizuar projektligji për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, që është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës për procedim në Kuvend dhe Statuti (MSh) Nr. 01/2024 i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës që është aprovuar nga Ministri i shëndetësisë. Ministria e Shëndetësisë, në përputhje me angazhimin për mbrojtjen e shëndetit publik dhe reduktimin e ndikimit të përdorimit të duhanit, dhe pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të Udhëzimit administrativ Nr. 02/2024, i cili ndryshon dhe plotëson Udhëzimin administrativ Nr. 05/2023 për vërejtjet e kombinuara, njofton se nga sot fillon zbatimi i këtij udhëzimi. Të gjitha produktet e duhanit që importohen apo prodhohen për tregun e Republikës së Kosovës duhet të përmbajnë fotografi me ngjyra ose ilustrime të tjera dhe të përmbajnë vërejtjet shëndetësore të përcaktuara në këtë Udhëzim administrativ. Vërejtjet shëndetësore do të shfaqen në paketimet e të gjitha produkteve të duhanit për tymosje, produkteve të duhanit që nuk tymosen, si dhe produkteve të reja të duhanit. Në përputhje me Planin e veprimit për përcaktimin e kriterëve për regjistrin e banorëve në kujdesin parësor shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë ka filluar projektin për përzgjedhjen e mjekut familjar brenda zonës së banimit.

Ky projekt, pas periudhës testuese në katër komuna dhe regjistrimit të popullsisë për përcaktimin e numrit të saktë të banorëve, do të zgjerohet në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, dhe do të zgjasë 100 ditë, ndërsa projekti i plotë pritet të përfundojë deri në fund të vitit 2025. Përmes këtij procesi synohet krijimi i një liste të saktë të banorëve dhe pacientëve për mjekët familjarë, duke u fokusuar në një organizim më efektiv të shërbimeve shëndetësore. Vizitat shëndetësore në shtëpi janë zbatuar në 29 komuna, ndërsa janë raportuar nga 22 komuna. Numri i vizitave mjekësore në shtëpi për nënën dhe fëmijë 0-3 vjeç për muajin korrik-shtator të vitit 2024 është 17,666 ndërsa për kujdesin paliativ nuk kemi pranuar raport nga autoritetet komunale.

Ministria e Shëndetësisë ka nënshkruar kontratat me dhjetë Organizata Joqeveritare (OJQ) që kanë përfituar nga mbështetja financiare sipas thirrjes publike “Promovimi i Shëndetit Mendor, Promovimi dhe Parandalimi i Sëmundjeve Infektive HIV dhe TB, si dhe fuqizimi i të rinjve për një jetë të shëndetshme”. OJQ-të do të zhvillojnë aktivitete parandaluese, promovuese, edukative dhe avokuese, ndërsa buxheti i ndarë është 132,000 euro.

Aktivitete kryesore në kuadër të agjendës evropiane gjatë periudhës raportuese kanë qenë në zbatimin e obligimeve që dalin nga ky proces, me theks në përgatitjen e kontributit të dytë për raportin e progresit të Komisionit Evropian për Kosovë 2024 si dhe monitorimi i zbatimit të programit kombëtar për integrim evropian. Në kuadër të koordinimit të politikave gjatë periudhës raportuese janë hartuar raportet për zbatimin e Planit kombëtar për zhvillim, përgatitja e raporteve për zbatimin e programit të qeverisë dhe të vendimeve të qeverisë ku janë hartuar raporti i tremujorit të dytë dhe të tretë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe raporti tremujor për zbatimin e planit kombëtar për zhvillim 2024-2026. Në kuadër të monitorimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, departamenti, ka përditësuar dhe proceduar në ZKM raportin për nivelin e zbatimit të marrëveshjes në fushën e shëndetësisë me Republikën e Shqipërisë.

Në kuadër të koordinimit të asistencës teknike, Ministria ka marrë konfirmimin nga Ministria e Financave punës dhe transfereve që projekti kredisë i financuar nga Banka Botërore “Qasja gjithëpërfshirëse e Kosovës për forcimin e sistemit të shëndetësisë,” është proceduar në kuvend për miratim. Sa i përket Planit strategjik për sigurimin e pajisjeve për të gjitha institucionet e nivelit dytësor dhe tretësor, Ministria është në proces të finalizimit të diskutimeve rreth financimit të me Bankën zhvillimore të Këshillit të Evropës dhe Bankën investuese të Evropës.

Aktualisht, është duke u zhvilluar studimi i fizibilitetit WB21-KOS-SOC-01 me komponentët e lidhjes së korridoreve të ngrohta në mes klinikave në SHSKUK, qasjen e personave me aftësi të kufizuar në institucione shëndetësore dhe vlerësimin për kujdesin paliativ në tri nivelet e kujdesit shëndetësor përfshirë Hospicën. Në kuadër të komunikimit me ekipin për zbatimin e studimit të fizibilitetit IPF 11, është rekomanduar që në vlerësim të përfshihen praktikatat më të mira të vendeve të Evropiane sa i përket kujdesit paliativ, përfshirë edhe Hospicën. Ministria e Shëndetësisë gjatë kësaj periudhe ka përfituar donacione me vlerën e përgjithshme prej 2,965,966.71 euro.

Sa i përket zhvillimit të sistemit të informimit shëndetësor, Ministria pas miratimit të Planit strategjik për sistemin e informimit 2023-2030, është fokusuar në përgatitjet për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara sipas afateve dhe prioritetëve të fushave përkatëse. Një intensifikim i aktiviteteve pritet pas fillimit të zbatimit të kredisë së Bankës Botërore që do të mbështet zhvillimin e sistemin e informimit shëndetësor me rreth 12 milion euro. Gjatë këtij tremujori janë zhvilluar aktivitete për të përmirësuar sistemet e menaxhimit dhe mbikëqyrjes me theks ndërlidhjen e sistemit të mbikëqyrjes të sëmundjeve ngjitëse me sistem dhe ndërlidhjen me agjencinë e regjistrimit civil. Mbështetja teknike ka vazhduar rreth përdorimit të sistemit për modulën e vaksinimit të rregullt dhe me indikacione, modulit në SMSF, modulit të BHIS për të gjitha komunat.

Në kujdesin parësor shëndetësor, Ministria, ka qenë e angazhuar në fuqizim të kapaciteteve njerëzore në kuadër të programit specialistik, ku është hartuar lista përfundimtare e mjekëve të përgjithshëm dhe specialisteve të Mjekësisë familjare për tu përzgjedhur si mjekje familjar. Është aprovuar plani i veprimit për standardizimin e inventarit dhe funksionimit të unifikuar të dhomave për promovim dhe edukim në kujdesin parësor shëndetësor dhe është hartuar Qarkorja informative Nr. 09-2024 për fillimin e procesit e fushatës vetdijësuese për përzgjedhjen e mjekut familjar.

Ministria e Shëndetësisë ka vazhduar furnizimin e institucioneve të KPSH-së me barna dhe material shpenzues nga lista e barnave esenciale sipas planifikimit të institucioneve shëndetësore për periudhën tremujore. Sa i përket furnizimit me barna dhe materiale shpenzuese për institucionet e kujdesit parësor shëndetësore, nga kontratat aktive të futura në sistem është 78% ndërsa me material shpenzues 90 %, ndërsa furnizimi me insulina, vaksina dhe terapi antituberkulare dhe ARV është 100%. Vlen të theksohet që gjatë kësaj periudhe janë siguruar produktet për sëmundjet e rralla dhe janë furnizuar institucionet me njëzetepesë produkte të reja, ndërsa furnizimi me barna për programe specifike (fibroza cistike, okrelizumab, dornase alfa, interferon Beta1a22mcg, Interferon Beta1amcg, interferon Beta1b 250mcg,taliglucerase,imiglucerase) është realizuar 100%.

Në fushën e pajisjeve dhe produkteve mjekësore është vazhduar me vlerësimin e dokumentacionit në procesin e lëshimit, ripërtëritjes të certifikatave të autorizim marketingut, vlerësimit të variacioneve si dhe aktivitetet e Farmakovigilencës me referencë të veçantë për aktivitetet e menaxhimit të rrezikut, aktivitetet e licencimit të veprimtarive, lejeve të importit, analizat laboratorike të kontrollit cilësisë.

Instituti Special në Shtime që është transferuar në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë ofron kujdesit social rezidencial 24 orë për 70 rezidentë që kanë shkallë të ndryshme të retardimeve mendore. Këtyre rezidentëve u është ofruar kujdes mjekësor dhe barna përmes kontrolleve mjekësore sistematike dhe periodike me qëllim të ruajtjes së shëndetit dhe lehtësimit të jetës. Të gjitha rastet që kanë pasur nevojë për kontrolle mjekësore jashtë institucionit janë dërguar sipas rekomandimeve të specialistëve të fushës dhe të gjitha shërbimet janë kryer sipas procedurave dhe nevojave që kanë pasur rezidentët.

Qendra Kombëtare e Kosovës për transfuzionin në tremujorin e tretë të këtij viti ka realizuar 7306 dhurime të gjakut. Prej tyre 4379 dhurime janë realizuar në QKKTGJ Prishtinë dhe 2927 dhurime në shtatë Qendrat e Transfuzionit të Gjakut(QTGj). Për të arritur vetëmjaftueshmërinë me gjak dhe përbërës të gjakut Sektori i marketingut është angazhuar me organizimin e sesioneve të dhurimit të gjakut ku në tremujorin e tretë të vitit 2024 janë organizuar 79 sesione të dhurimit vullnetar të gjakut, respektivisht një më shumë se në tremujorin e tretë të vitit të kaluar 2023. Dhurimi i gjakut ishte i fokusuar në grumbullimin e gjakut në terren përmes ekipeve mobile për të qenë sa më afër dhuruesve të gjakut, dhe rezultatet tregojnë që nga ky numër i dhurimeve kishte ngritje të përqindjes së dhurimit vullnetar të gjakut në terren për 3.1% më shumë në vitin 2024 krahasuar me tremujorin e tretë vitit paraparak 2023. Po ashtu edhe në QTGJ dhurimi vullnetar i gjakut kishte ngritje për 7.7% më shumë se në vitin paraparak 2023, edhe pse numri i përgjithshëm i dhuruesve ishte më i vogël.

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të Departamentit shëndetësor të burgjeve, kanë funksionuar të gjitha shërbimet sipas planit dhe indikacioneve shëndetësore. Trajtimi i rasteve me çrregullime mendore dhe përdorues të drogave, përmes terapisë mbajtëse me metadon, ka vazhduar pa ndërprerë në të gjitha njësitë. Institucioni për trajtimin e personave me nevoja të veçanta përfshirë të moshuar, persona me nevoja të veçanta, të sëmurë kronik, persona me çrregullime mendore dhe përdorues të drogave ka ofruar shërbime shëndetësore.

Ministria e Shëndetësisë ka barazuar gjendjen fizike me atë elektronike të transaksioneve për muajt prill-qershor me programet vartëse dhe programet tjera brenda Ministrisë. Është bërë raportimi i obligimeve dhe kontratave aktive sipas kërkesës së Ministrisë së financave punës dhe transfereve. Ministria e Shëndetësisë për vitin 2024 sipas Ligjit të Buxhetit ka buxhet në vlerë prej 83,488,684.10 €. Në tërësi

gjatë vitit 2024 janë shpenzuar 36,658,691.87.€ apo 43.91%% e buxhetit. Në tabelën e mëposhtëm është paraqitur pasqyra e buxhetit për tremujorin e tretë të vitit 2024. Gjatë periudhës raportuese janë publikuar tridhjetenjë aktivitete të prokurimit dhe janë nënshkruar njëzetedy kontrata.

Investimet kapitale në vitin 2024 janë kryesisht vazhdimësi e projekteve nga vitet e kaluara të cilat nuk kanë mundur të fillojnë me kohë si rrjedhojë e projekteve të mangëta dhe jo profesionale. Gjithsesi Ministria me qëllim të ngritjes së nivelit të shfrytëzimit të mjeteve për investime kapitale ka ndërmarrë hapat e nevojshme që projektet kapitale të parapara për vitin 2024 dhe mjetet e ndara financiare për këtë qëllim të shfrytëzohen maksimalisht dhe brenda afatit të përcaktuar.

Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit është bërë përmes inspektorateve respektive, shëndetësore, farmaceutike dhe sanitare. Aktivitetet kryesore të këtyre inspektorateve janë fokusuar kryesisht në zbatimin e legjislacionit ku janë kryer aktivitete inspektuese të planifikuara, ri inspektime, inspektime tematike dhe specifike të inspektoratit shëndetësor, përdërisa inspektorati farmaceutik aktivitetet i ka bazuar në faktorin e rrezikut, i cili është udhërrëfyes i aktiviteteve që janë zhvilluar nga inspektorati farmaceutik dhe të cilat do të jenë në funksion të ngritjes së performancës së zinxhirit legal prodhues, furnizues dhe shpenzues me produkte dhe pajisje medicinale si dhe kuadrit profesional. Inspektimet sanitare kryesisht kanë qenë të fokusuar në zbatim të ligjit të kontrollit të duhanit.

Në komunikimin me publikun, Ministria e Shëndetësisë ka qenë kryesisht e fokusuar në prezantimin e aktiviteteve të ndërlydhura me prioritetet kryesore, siç janë: miratimi i politikave të reja, vizitat e Ministrisë të Shëndetësisë në institucionet shëndetësore, promovimi i aktiviteteve infrastrukturore, pajisjeve dhe inventarëve, përgatitja e materialeve informuese, promovimi i kampanjës vetdijësuese për përzgjedhjen e mjekut familjar në Republikën e Kosovës dhe shënimin e ditëve dhe javëve botërore të shëndetësisë publike.

Për periudhën raportuese, nga Njësia e auditimit të brendshëm është vazhduar me aktivitetet të cilat janë në kuadër të planit vjetor të auditimit, përfshirë angazhimet sipas kërkesës së menaxhmentit. Bazuar në planin e veprimit për tremujorin e tretë (2024) janë paraparë të zbatohen katër (4) rekomandime, nga të cilat një është zbatuar, dy rekomandime janë në proces të zbatimit dhe një rekomandim nuk është zbatuar.

Raporti i Zyrës kombëtare të auditimit për pasqyrat vjetore financiare 2023 të Ministrisë së Shëndetësisë ka evidentuar gjashtë (6) të gjetura. Ministria nuk është pajtuar për dy të gjetura. Për adresimin e këtyre të gjeturave dhe adresimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra kombëtare të auditimit (ZKA), Ministria në vitin 2024 ka hartuar planin për zbatimin e rekomandimeve të ZKA për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2023. Niveli i zbatimit të këtij plani është raportuar në Zyrën kombëtare të auditimit gjatë muajit Shtator 2024, bazuar në legjislacionin në fuqi.

Me institucionin e Avokatit të popullit, përkatësisht mekanizmin kombëtar për parandalimin e torturës ka vazhduar bashkëpunimi i ndërsjellët ku janë dhënë përgjigje për rastet e caktuara me kërkesë të tyre. Gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur asnjë rekomandim për zbatim nga ky mekanizëm.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Rregulloren (ZKM) nr. 15/2024 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Shëndetësisë. Pas miratimit të rregullores ka filluar konsolidimi i kapaciteteve me burime njerëzore, ku rolet dhe përgjegjësitë sipas strukturës së re do të reflektojnë mbulimin e të gjitha përgjegjësive aktuale dhe përgjegjësive të reja. Gjatë këtij tremujore janë rekrutuar katër pozita dhe janë në proces pesë pozita të reja.

Mbeten shqetësuese, vonesat në vendimmarrje nga Organi shqyrtues i prokurimit OSHP që do të ndikojnë në nivel të ultë të zbatimit të projekteve kapitale dhe bartje të projekteve në vitin 2025, që do të rezultojnë me shfrytëzim të ultë të buxhetit.

2. Ruajtja dhe përparimi i shëndetit

2.1 Shëndeti publik

Në kuadër të ruajtjes së shëndetit publik, është zhvilluar mbikëqyrja dhe përcjellja e situatës epidemiologjike. Sa i përket virusit “*West Nile*” është bërë testimi për rastet e dyshimta, konfirmimi laboratorik dhe raportimi i rasteve pozitive. Janë grumbulluar analizat e rezultateve të ujit për pije, ku të gjitha mostrat rezultojnë brenda standardeve të parapara për ujin e pijes sipas UA 16/2021 për cilësinë e ujit të destinuar për konsum njerëzor. Gjatë periudhës raportuese është përcjellë dhe monitoruar ndikimi i toksinave kimike dhe mikrobiologjike me origjinë nga ushqimi, THM, TOC, pesticidet në ujë, metalet e rënda, mineraleve, në ujerat e pijshëm dhe rekreativ dhe ndikimi i tyre në shëndetin e popullatës. Sa i përket statistikave shëndetësore janë përgatitur të dhënat për dhjetë diagnoza më të shpeshta nga viti 2012 -2022 (nga të gjitha diagnozat) të morbiditetit të raportuara nga institucionet shëndetësore publike të të tre niveleve të kujdesit shëndetësor.

Indikatorët bazë të performancës

- Analiza për situatën epidemiologjike me COVID-19, projeksionet dhe të dhënat nga laboratorit për sekuençionim dhe rekomandimet e përgatitura;
- Buletinet mujore për sëmundje ngjitëse të shpërndara;
- Situata epidemiologjike me Sindromën meningjeale e monitoruar;
- Situata epidemiologjike me Hepatitit B dhe Hepatitit C e monitoruar;
- Situata epidemiologjike me ethet hemorragjike e monitoruar;
- Sëmundjet që përhapen me ujë dhe ushqim të monitoruara;
- Sëmundjet që përhapen (Borrelioza, Malaria, WNV, Leishmaniaza) të monitoruara;
- Zoonozat (Toksoplazmoza dhe Leptospiroza) të mbikëqyrura;
- Situata epidemiologjike me HIV/AIDS/IST e mbikëqyrur;
- Rezultatet e ujit për pije të analizuara;
- Mostrat e arritura nga AUV dhe Inspektorati sanitar të testuara.

2.1 Vaksinimi

Sa i përket vaksinimit është bërë grumbullimi dhe analizimi raporteve mujore të vaksinimit nga komunat si dhe rumbullimi i të dhënave nga sesionet me prindër dhe analizimi i tyre një nga një. Janë zhvilluar takime për komunikim dhe mobilizim social për vajzat për marrjen e vaksinës HPV. Është bërë planifikimi i sesioneve informuese me prindër në shkolla me vajzat e klasave të VI-ta të dhe të VII-ta, për vaksinën e HPV-së .

Indikatorët bazë të performancës

- Një (1) raport mujor përgatitur për stokun evaksinave në platformën digjitale VIVA i realizuar;
- Një (1) takim online i realizuar me komunat për organizimin, fillimin dhe mbarëvajtjen e vaksinimit me vaksinën e gripit sezonal për sezonin 2024/2025;
- Furnizimi tremujor i vaksinave të kalendarit të rregullt dhe vaksinës së gripit sezonal i shpërndarë në të gjitha komunat.

3. Progresi me planin e punës – rezultatet e indikatorëve kyç të performancës

3.1 Hartimi i strategjive dhe i politikave

Me qëllim të realizimit të synimeve strategjike dhe specifike të parapara në Planin kombëtar për zhvillim, Ministria e Shëndetësisë ka vazhduar procesin e hartimit të strategjive dhe të planeve specifike. Përgjatë kësaj periudhe janë hartuar dhe aprovuar pesë (6) plane të veprimit në zbatim të kornizës ligjore dhe të standardeve në fuqi.

Indikatorët bazë të performancës

- Një (1) Plan strategjik kombëtar për laboratorë i Kosovës 2024-2030 i aprovuar;
- Një (1) Plan i veprimit për trajtimin e fëmijëve abuzues me narkotik i aprovuar;
- Një (1) Program për skринing neonatal i aprovuar;
- Një (1) Plan i veprimit për siguri shëndetësore 2024-2026 i aprovuar;
- Një (1) Udhëzuesi i praktikave standarde të veprimit për trajnimin dhe rehabilitimin e personave me prapambetje mendore dhe fizike në institutin special në Shtime i aprovuar;
- Një (1) Planprogrami për trajnimin për paramedik i aprovuar.

3.2 Zbatimi i programit dhe i planit legjislativ

Në zbatim të Programit dhe të planit legjislativ, ka vazhduar të monitorimi i procesit të hartimit të legjislacionit. Në tre mujorin e tretë të këtij viti ka pasur progres pozitiv për miratimin e projektligjit për siguri të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor dhe miratimin paraprak të projektligjeve për shëndetësi, për kontrollin e duhanit dhe inspektoratin qendror shëndetësor. Gjatë kësaj periudhe është miratuar dhe publikuar në Gazetën zyrtare Statuti i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës.

Indikatorët bazë të performancës

- Projektligji për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor (është aprovuar me datën 28/08/2024);
- Me datën 18/09/2024 është publikuar në platformën e konsultimeve publike Projektligji për Inspektoratin qendror të shëndetësisë;
- Me datën 25/09/2024 është publikuar në platformën e konsultimeve publike Projektligji për duhanin;
- Projektligji Shëndetësi është finalizuar, në proces të përkthimit;
- Projektligji për shëndetin mendor, është pranuar përgjigjja pozitive e ekspertit të TAIEX, planifikohet të angazhohet në muajin nëntor;
- Projektligji për produkte dhe pajisje medicinale (në proces të finalizimit të tabelave);
- Projekt Udhëzimi administrativ për bashkë-pagesat në kujdesin shëndetësor është proceduar në konsultime brenda institucioneve deri më 04/10/2024.

Aktet ligjore në proces të miratimit në Kuvendin e Kosovës:

- Projektligji për Shëndet Riprodhues dhe Fertilizimin të Asistuar Mjekësor është aprovuar në parim nga Kuvendi i Kosovës dhe është në procedurë miratimit.

Aktet ligjore dhe nënligjore në procedurë të aprovimit;

- Me datë 09.07.2024 është nënshkruar nga Ministri dhe është publikuar në Gazetën Zyrtare Statuti (MSh) Nr. 01/2024 i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës;
- Projekt Rregullorja (QRK) 00/2024 Për procedurën e pranimit të nëpunësve në të shërbimit publik në sektorin e shëndetësisë është finalizuar dhe përcjellë në Qeveri.

3.3 Hartimi i Udhërrëfyeseve dhe i Protokolleve Klinike

Sa i përket hartimit të standardeve dhe praktikave të mira shëndetësore, përmes hartimit të udhërrëfyeseve klinik dhe protokolleve klinikë në këtë periudhë janë në proces të hartimit dhe finalizimit 62 udhërrëfyese klinik dhe 3 protokolle klinike.

Indikatorët bazë të performancës

Udhërrëfyesei klinik në zhvillim

- UK - Menaxhimi i TB/MDR (Udhërrëfyesei duhet hartuar nga fillimi sepse OBSH e ka ndërruar dhe shkurtuar mjekimin);
- UK - Diagnostikimi dhe trajtimi i Sklerozës Multiple (në fazën e kostimit);
- UK - Menaxhimi i diabetit të fëmijët dhe adoleshentët (në proces);
- UK - Menaxhimi i komplikimeve të sëmundjes së sheqerit (në fazën e kostimit);
- UK - Menaxhimi i hipertensionit dhe modifikimet në stilin e jetës për pacientët në kujdesin dytësor shëndetësor (në KVMAUPK);
- UK - Qasja jo farmakologjike dhe farmakologjike karshi hipertensionit në pacientët në KDSH (në KVMAUPK);
- UK - Kujdesi antenatal në KPSH (në fazën e kostimit);
- UK - Kujdesi postnatal në KPSH (në fazën e kostimit);
- UK - Trajtimi i kancerit të gjirit si sëmundje e lokalizuar, lokalisht e avancuar dhe metastatike ose rekurente (në KVMAUPK);
- UK- Trajtimi i kancerit të mushkërive, me qeliza jo të vogla, me qeliza të vogla dhe mesotheliomave (në recenzion);
- UK - Trajtimi i melanomave malinje lokalisht të avancuara dhe metastatike (në KVMAUPK)
- UK - Fibroza cistike (në proces);
- UK - Sëmundja e Gaucher-it (në konsultim publik);
- UK - Lindjet me prerje cezariane (në KVMAUPK);
- UK - Menaxhimi i lindjes normale (në KVMAUPK);
- UK - Sëmundjet Kronike Obstruktive Pulmonare për KPSH & KDSH (në fazën e kostimit);
- UK - Mjekësia fetale (në proces);
- UK - Sëmundja e Bruton-it (në proces);
- UK - Menaxhimi i TB Pediatrik (në proces);
- UK - HIV Testimi – Revidim (në proces);
- UK - Menaxhimi i dislipidemive (në proces);
- UK - Menaxhimi i osteoporozës (në proces);
- UK - Menaxhimi i pamjaftueshmërisë së zemrës (në proces);
- UK - Menaxhimi i sëmundjes iskemike të zemrës (në proces);
- UK - Masat parandalues të vetëvrasjes/Përdorimi i mjeteve të kufizimit (në proces);

- UK - Menaxhimi i sëmundjes Alzheimer dhe demencave tjera (në proces);
- UK - Menaxhimi i kokë dhimbjes (në proces);
- UK - Menaxhimi i marra mendjes (në proces);
- UK - Menaxhimi i infeksioneve të traktit urinar jo të komplikuar (në proces);
- UK - Menaxhimi i dermatozave alergjike, ekzematose & ekzantemave (në proces);
- UK - Menaxhimi i astmës të fëmijët deri në moshën 5 vjeçare (në proces);
- UK - Menaxhimi i dhimbjes kronike (në proces);
- UK - Menaxhimi i mbipeshës dhe obezitetit (në proces);
- UK - Menaxhimi i infeksioneve të traktit të sipërm respirator (në proces);
- UK - Menaxhimi i infeksioneve të traktit të poshtëm respirator (në proces);
- UK - Menaxhimi i glomerulonefriteve kronike (në proces);
- UK - Menaxhimi i venave varikoze dhe varikoflebite (në proces);
- UK - Menaxhimi i sindromes së distresit akut respirator të të rriturit (në proces);
- UK - Menaxhimi i diarreve kronike (në proces);
- UK – Trajtimi i emergjencave në psikiatrinë e fëmijëve dhe adoleshentëve (në proces);
- UK - Menaxhimi i shenjave të mbidozës, trajtimit dhe administrimit të Naloxon-it (në proces);
- UK - Menaxhimi farmakologjik i sëmundjes së sheqerit Tip 2 të të rriturit (përditësim i UK të vitit 2022) (në proces);
- UK - Diagnoza dhe menaxhimi i hiperplazisë endometriale (në proces);
- UK - Menaxhimi i Diabetit në shtatzëni (në proces);
- UK - Vlerësimi dhe trajtimi i infertilitetit (në proces);
- UK - Diagnoza dhe menaxhimi i shtatzënave ektopike (në proces);
- UK - Menaxhimi i sindromes akute trunore në KPSH (në proces);
- UK - Menaxhimi i djegieve (në proces);
- UK - Menaxhimi i skoliozës idiopatike (në proces);
- UK - Ventilimi invaziv dhe joinvaziv (në proces);
- UK - Qasja kirurgjike e sëmundjeve të gjirit (në proces);
- UK - Qasja diagnostike e pagjakësisë të të rriturit (në proces);
- UK - Qasja diagnostike e pagjakësisë të fëmijët (në proces);
- UK - Diagnostikimi i infeksioneve të gjakut dhe mostrave të tjera sterile (në proces);
- UK - Trajtimi i depresionit (në proces);
- UK - Trajtimi i pacientëve me Skizofreni (në proces);
- UK - Trajtimi me dializë pritoneale i të rriturve (në proces);
- UK - Skriminimi dhe trajtimi i lezioneve prekanceroze të qafës së mitrës (në proces);
- UK - Menaxhimi i pankreatitit akut (në proces);
- UK - Trajtimi i retinopatisë të prematuritetit (në proces);
- UK - Trajtimi i retinopaitisë diabetike (në proces);
- UK - Trajtimi i glaukomës (në proces);

Protokolle Klinike në zhvillim:

- PK - Përdorimi i oksidulit rezidual-sedacionit inhalator në stomatologji (në proces);
- PK - Menaxhimi jo farmakologjik i Diabetit (në proces);
- PK - Diabeti tip 2 në KPSH (në lektorim).

3.4 Zbatimi i planeve kombëtare për zhvillim dhe integrim evropian

Aktivitete kryesore në kuadër të agjendës evropiane gjatë periudhës raportuese kanë qenë në zbatimin e obligimeve që dalin nga agjenda evropiane, me theks në përgatitjen e kontributit të dytë për raportin e progresit të Komisionit Evropian për Kosovë 2024 si dhe monitorimi i zbatimit të programit kombëtar për integrim evropian. Në kuadër të koordinimit të politikave gjatë periudhës raportuese janë hartuar raportet për zbatimin e Planit kombëtar për zhvillim, përgatitja e raporteve për zbatimin e programit të qeverisë dhe vendimeve të qeverisë.

Indikatorët bazë të performancës

- Një (1) Strategji sektoriale shëndetësore 2025-2030 e finalizuar;
- Një (1) Plan i veprimit për zbatimin të Strategjisë sektoriale shëndetësore 2025-2030 i finalizuar;
- Një (1) raport i përgatitur për kontributin e dytë për raportin e KE-së për Kosovën -2024/ Shëndeti Publik;
- Një (1) raport i përgatitur për kapitullin e 28 me pyetjet shtesë të Komisionit Evropian;
- Një (1) raport i përgatitur për kapitullin e 3 me pyetjet shtesë të Komisionit Evropian;
- Një (1) raport i përgatitur për kapitullin e 1 me pyetjet shtesë të Komisionit Evropian;
- Një (1) raport i përgatitur për Vlerësimin e asistencës teknike të ofruar nga Komisioni Evropian sipas pyetësorit;
- Një (1) raport i (tremujorit të dytë) i përgatitur për Ministrinë e Shëndetësisë;
- Një (1) raport i përgatitur (tremujorit të dytë) për zbatimin e planit kombëtar për zhvillim 2024-2030 për Ministrinë e Shëndetësisë;
- Një (1) raport i përgatitur për zbatimin e planit të integritetit të MSh, sipas kërkesës së Agjencisë për parandalim të korrupsionit, dy format narrative dhe tabelorë;
- Një (1) raport i përgatitur për Menaxhimin e rrezikut institucional të MSh (janar – qershor 2024);
- Një (1) raport i përgatitur për gjashtë mujorin e Planit të Integritetit Institucional (Janar-qershor 2024);
- Një (1) raport i përgatitur për zbatimin e protokollit shtesë në zbatimin të marrëveshjes së bashkëpunimit me Republikën e Shqipërisë në fushën e shëndetësisë;
- 15 lëndë të trajtuara në kuadër të Komitetit drejtues për ekspertizë në ZKM;
- Një (1) kërkesë e hartuar për MFPT që të njoftohemi për kushtet e kredisë të ofruara nga Fondi Saudit në lidhje me projektin e ndërtimit të Klinikës së Pulmologjisë.

3.5 Kujdesi parësor shëndetësor

Gjatë këtij tremujori Divizioni për kujdesin parësor shëndetësor ka vazhduar me aktivitetet që janë pjesë e planit të punës, ku është finalizuar plani i veprimit për furnizim me inventar për dhoma të edukimit për gra shtatzëna, nëna dhe fëmijë dhe plani i veprimit për kriteret e përzgjedhjes së mjekut familjar. Ka filluar fushata 90 ditësh për përzgjedhjen e mjekut familjar.

Indikatorët bazë të performancës

- 17,666 vizita mjekësore të realizuara në shtëpi për fëmijë 0-3 vjeç
- Lista e mjekëve të përgjithshëm dhe specialisteve për tu përzgjedhur si mjek familjarë e finalizuar;
- Një (1) Qarkorje informative Nr. 09-2024 e finalizuar dhe e proceduar për fillimin e fushatës vetdijësuese për përzgjedhjen e mjekut familjar;
- Vlerësimet profesionale për statute të QKMF të ofruara;

- Ri akreditimi i programit specialisitk 3 vjeçar për Mjekësi Familjare nga RCGP i përditësuar;
- 8 specializant të Mjekësisë Familjare fillojnë specializimin;
- 365 vizita preventive shtëpiake të realizuara për grupe të cenushme të shoqërisë (fëmijët dhe nënat);
- 7,065 vizita në shtëpi për fëmijët 0-3 vjeç;
- 1,011 vizita në shtëpi për shtatzëna.

3.6 Furnizimi me barna për KPSH

Me qëllim të sigurimit të barnave të institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë ka vazhduar furnizimin e 34 QKMF me barna dhe material shpenzues nga lista esenciale sipas planifikimit të vet institucioneve, me porosi të rregullta dhe emergjente varësisht nga nevojat e tyre për periudhën tremujore.

Indikatorët bazë të performancës

- 78% furnizimi me barna;
- 90% furnizimi me material shpenzues:
- 100% furnizimi me insulina;
- 25 produkte të reja për barna e sëmundjeve të rralla;
- 100% furnizimi me vaksina;
- 100% furnizimi me terapi antituberkulare dhe ARV;
- 100% furnizimi me barna për programe specifike fibroza cistike, okrelizumab, dornase alfa, interferon Beta1a22mcg, Interferon Beta1amcg, interferon Beta1b 250mcg, taliglucerase, imiglucerase.

3.7 Asistenca teknike dhe marrëveshjet financiare

Sa i përket asistencës teknike është vazhduar me koordinim dhe komunikim të rregullt me agjencitë dhe partnerët strategjik që mbështesin sektorin e shëndetësisë. Fokusi është vënë në finalizimin e procedurave për financim të planit strategjik për zbatimin e studimit të fizibilitetit 2023-2026 me partnerët finansues Bankën zhvillimore të Këshillit të Evropës dhe Bankën investues të Evropës. Gjatë periudhës raportuese është hartuar dhe proceduar Qarkorja për procedurat e pranimit të donacioneve në Departamentet për shëndetësi dhe mirëqenie sociale në Komuna. Ministria e Shëndetësisë gjatë këtij tremujori ka përfituar donacione me vlerën e përgjithshme 2, 965, 966.71 euro.

Indikatorët bazë të performancës

- Një (1) diskutim zyrtar i zhvilluar me Qendrën Spitalore Sheba në Izrael për ofrimin e asistencës teknike në fuqizimin e kapaciteteve të emergjencave;
- Një (1) diskutim zyrtar i zhvilluar me ekipin për studimin e fizibilitetit WB21-KOS-SOC-0 për fazën e dytë;
- Një (1) diskutim zyrtar i zhvilluar me përfaqësues të Fondit Saudit dhe MFPT për projektin e ndërtimit të Klinikës së Pulmologjisë;
- Një (1) marrëveshje mes Ministrisë së Shëndetësisë së Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë së Kroacisë;
- Një (1) koordinim i komunikimit zyrtar me EBA në lidhje me përmbajtjen e marrëveshjes me theks në pjesën e paraparë për meremetimin e QKMF Vushtrri;
- Një (1) kërkesë e përgatitur dhe e proceduar për asistencë teknike përmes TAIEX për mbështetje të grupit punues për hartimin e projektligjit për shëndet mendor;

- Një (1) kërkesë e përgatitur dhe e proceduar për asistencë teknike dhe ekspertizë për përgatitje të doracakut për monitorim dhe vlerësim të SSSh të projekti i AQH;
- Një (1) qarkore është hartuar dhe proceduar për procedurat e pranimit të donacioneve në Departament për shëndetësi dhe mirëqenie sociale në Komuna;
- Një (1) raport i përgatitur për donacione të komunitetit serb për vitin 2023-2024;

3.9. Shërbimet shëndetësore

Gjatë periudhës raportuese është miratuar programi për skringut neonatal dhe ka përfunduar planifikimi i barnave për periudhën tri vjeçare për barnat ATB, ARV dhe materialit harxhues për laboratorët. Është përcjellë zbatimi i protokollit për mbikëqyrjen dhe kontrollin e rasteve me Mpi, i miratuar në komitetin për sëmundje ngjitëse në IKSHPK te tri nivelet shëndetësore si dhe pikat kufitare. Është zhvilluar analiza e raporteve të programit të terapisë mbajtëse me metadon dhe njoftimi për mbarëvajtjen e procesit.

Indikatorët bazë të performancës

- Një (1) raport për aktivitetet në fushën e ShNF/ShR, sipas kërkesës së komitetit të përbashkët drejtues të ZKM-së dhe Zyrës koordinuese të OKB-së i hartuar;
- Një (1) Program për skring neonatal i miratuar;
- Planifikimi i aktiviteve për shëndetin e nënës dhe fëmijes me UNFPA për vitin 2025 i realizuar;
- 23,000 fletore për shëndetin e fëmijës janë publikuar;
- Një (1) raport lidhur me situatën epidemiologjike të COVID-19 i analizuar;
- Një (1) raport për TB, HIV dhe sëmundje tjera ngjitëse i hartuar
- Planifikimi i barnave ARV, ATB dhe materialit hargjues për periudhën 2025-2027 i përgatitur;
- Aktivitetet e planifikuara për shëndetin mendor për vitin 2024, të hartuara;
- Raportet mujore të programit të terapisë mbajtëse me metadon nga SP. Pejë, A.S. Labyrinth, SP Gjilan, Kl. Psikiatrike/QKUK, SP. Prizren, SP. Gjakovë, DShB të analizuar;
- Të dhënat e programit të TMM-së të vendosura në bazën e të dhënave;

Shërbimet në Institutin special në Shtime

Të gjitha rastet që kanë pasur nevojë për kontrole mjekësore jashtë institucionit janë dërguar sipas rekomandimeve të specialistëve të fushës dhe të gjitha shërbimet janë kryer sipas procedurave dhe nevojave që kanë pasur rezidentët.

Indikatorët bazë të performancës

- 243 kontrolla të rregullta dhe sipas rastit;
- 56 kontrolla psikiatrike;
- 58 intervenime psikologjike;
- 28 kontrolla të përgjithshme dhe specialistike;
- 19 kontrolla stomatologjike,
- 16 shërbime të marra në nivelin sekondar;
- 9 shërbime të marra në nivelin terciar;
- 97 shërbime Ergoterapeutike (terapisë së punës);
- 35 shërbime të fizioterapisë;
- 406 dhënie terapisë paraneterale;
- 7 shërbime diagnostike laboratorike dhe imazherike jashtë ISSh;

Shërbimet shëndetësore në burgje

Gjatë periudhës prill – qershor të vitit 2024, Departamenti shëndetësor i burgjeve DShB ka funksionuar në njëmbëdhjetë (11) Njësi shëndetësore të burgjeve (NjShB) me shërbim 24 orësh. Numri i përdoruesve të drogave gjatë kësaj periudhe ka vazhduar të këtë rritje lineare, deri në 13.32% (150 raste të reja gjatë kësaj periudhe). Ka vazhduar trajtimi me metadon i përdoruesve të drogave të burgosur sipas indikacioneve. Në mbështetje të Këshillit të Evropës, ka vazhduar zbatimin e projektit “Përmirësimin e trajtimit për personat e privuar nga liria” me përgatitjen e procedurave standarde operative, zbatimin e tyre në vend të punës dhe trajnimin e trajnerëve. Me Institucionin e Avokatit të Popullit, përkatësisht mekanizmin kombëtar për parandalimin e torturës ka vazhduar bashkëpunimi ku janë ofruar përgjigje për rastet e caktuara me kërkesë të tyre.

Indikatorët bazë të performancës

- 46,932 shërbime shëndetësore të realizuara;
- 12,281 vizita sistematike të realizuara;
- 1,236 analiza laboratorike;
- 101 hospitalizime në stacionar të burgut;
- 145 hospitalizime në institucione të tjera.

3.10 Komunikimi me publikun

Divizioni i Komunikimit me Publikun gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, ka qenë kryesisht i fokusuar në prezantimin e aktiviteteve të Ministrisë të ndërlidhura me prioritetet kryesore, siç janë: miratimi i politikave të reja, vizitat e Ministrit të Shëndetësisë në institucionet shëndetësore, promovimi i aktiviteteve infrastrukturore, pajisjeve dhe inventarëve, përgatitja e materialeve informuese, promovimi i kampanjës vetdijësuese për përzgjedhjen e mjekut familjar në tërë Republikën e Kosovës dhe shënimin e ditëve dhe javëve botërore të shëndetësisë publike. Ky fokusim mbulon periudhën raportuese nga 1 korrik deri më 30 shtator 2024.

Indikatorët bazë të performancës

- 326 publikime në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë;
- 506 përgjigje të ofruara për media;
- 255 përgjigje të ofruara për palë të interesuara;
- 24 komunikata të lëshuara për media;
- 2 ftesa të përgatitura për media;
- 4 njoftime të përgatitura për media;
- 1 intervistë e dhënë për Radio Kosovën;
- 48 publikime në profilin e MSh-së në Facebook;
- 9 publikime në profilin e MSh-së në Instagram;
- 14 raporte javore të aktiviteteve të MSh/Kabinetit të Ministrit për Qeverinë;
- 2 përgjigje për AIP;
- 39 infografikëve lidhur me: ditët, javët dhe muajt botërorë në shëndetësi, kujdesin ndaj temperaturave të larta, si dhe statistika të ndryshme sipas kërkesave;
- 41 kërkesa për Qasje në dokumente publike, 40 janë të aprovuara për 1 kërkesë është ofruar vetëm përgjigje (qasje e pjesshme);
- 75 monitorime ditore të mediave.

3.11 Zhvillimi i sistemit të informimit shëndetësor

Sa i përket zhvillimit të sistemit të informimit shëndetësor, Ministria pas miratimit të Planit strategjik për sistemin e informimit shëndetësor është fokusuar në zbatimin e aktiviteteve të planifikuara sipas afateve dhe prioritetëve të fushave përkatëse. Gjatë këtij tremujori janë zhvilluar aktivitete për të përmirësuar sistemet e menaxhimit dhe mbikëqyrjes me theks ndërlidhjen e sistemit të mbikëqyrjes të sëmundjeve ngjitëse me sistem dhe ndërlidhjen me agjencinë e regjistrimit civil.

Indikatorët bazë të performancës

- Ndërlidhja e sistemit të Mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse me sistemin dhe ARC e përfunduar;
- Termat e referencës për mekanizmin mbikëqyrës e-shëndetësia, të finalizuara;
- Zhvillimet shtesë në Sistemi MEDLIS për përshtatjen e sistemit me proceset e punës në mikrobiologjinë klinike të përfunduara;
- Një (1) trajnim i përfunduar për përdorimin e sistemit MEDLIS për profesionistët i mikrobiologjisë klinike;
- Një (1) trajnimi i përfunduar për përdorim të sistemit MEDLIS në QRSHP Gjilan dhe QRSHP Ferizaj dhe QRSHP Mitrovicë;
- Një (1) Qasje e siguruar në SMSF për farmacistët në Klinikën e Pediatriisë në QKUK;
- Trajnimet për zbatim të modulit të metadonit në Klinikën e Psikiatriisë në Spitalin e Gjilanit të zhvilluara;
- Ridizajnimi i raporteve të sistemit të licencimit të Institucioneve Shëndetësore Private për të përmirësuar qartësinë dhe efikasitetin e raportimit i përfunduar;
- Instalimi i certifikatës SSL në serverin smsn.rks-gov.net dhe ip statike 10.230.0.188 për nevoja të sigurisë i përfunduar;
- Konfigurimi në infrastrukturën harduerike të SISH-it: Procesi i migrimit të VDI dhe Host nga serverët e vjetër në server të ri të përfunduar;
- Ri konfigurimi i serverëve në ASHI i përfunduar;
- Konfigurimi i pajisjeve (Router dhe switch) për 11 qendra në Komunën e Vitisë si dhe Funkcionalizimi i 4 qendrave në këtë Komunë i përfunduar;
- Krijimi i qasjes për mentorët klinikë në sistemin e specializantëve i zhvilluar;
- Përkrahje teknike rreth përdorimit të sistemit për modulën e Vaksinimi të rregullt dhe me indikacione si dhe rreth modulit në SMSF, modulit të BHIS për të gjitha komunat.

3.12. Inspektimet

Mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit është bërë përmes inspektorateve respektive, shëndetësore, farmaceutike dhe sanitare. Aktivitetet kryesore të këtyre inspektorateve janë fokusuar kryesisht në zbatimin e legjislacionit ku janë kryer aktivitete inspektuese të planifikuara, ri inspektime, inspektime tematike dhe specifike të inspektoratit shëndetësor, përdorisa inspektorati farmaceutik aktivitetet i ka bazuar në faktorin e rrezikut, i cili është udhërrëfyes i aktiviteteve që janë zhvilluar nga inspektorati farmaceutik dhe të cilat do të jenë në funksion të ngritjes së performancës së zinxhirit legal prodhues, furnizues dhe shpenzues me produkte dhe pajisje medicinale si dhe kuadrin profesional. Inspektimet sanitare kryesisht kanë qenë të fokusuar në zbatim të ligjit të kontrollit të duhanit.

Indikatorët bazë të performancës

- 366 inspektime shëndetësore të realizuara;
- 39 vendime të shkallës së parë në vlerë prej 72,550.00 euro ;
- 2 vendime të shkallës së dytë;
- Gjoha për inspektime shëndetësore në vlerë 68, 500.00 euro të lëshuara;
- 2,249 inspektime sanitare të realizuara;
- 2,249 inspektime për zbatimin e ligjit për kontrollin e duhanit të realizuara;
- 52 fletëparaqitje për inspektime sanitare;
- 79 inspektime të praktikës së mirë farmaceutike;
- 5 inspektime të praktikës së mirë farmaceutike të shpërndarjes;
- 17 ri inspektime të planifikuara bazuar në të gjeturat në inspektimet paraprake;
- 113 inspektime të planifikuara rreth kushteve të ruajtjes së produkteve dhe pajisjeve mjekësore;
- 45 inspektime të planifikuara rreth prezencës së stafit profesional;
- 9 mostra të planifikuara nga LKC/AKPPM (sipas planit të mostrimit);
- 10 inspektime me kërkesë për verifikim stoku të produkteve me afat të skaduar dhe të papërdorshme;
- 39 inspektime me kërkesë/parashtresë/NJHKEK;
- 42 inspektime me ankesë të palëve;
- 1 inspektime pasuese;
- 9 inspektime Ad- Hoc;
- Janë dërguar 23 lëndë në OPPK;
- Inspektorati farmaceutik ka shqiptuar 46 gjoha dhe ka lëshuar 46 vendime.

3.13. Pajisjet dhe produktet mjekësore

Në fushën e pajisjeve dhe produkteve mjekësore është vazhduar me vlerësimin e dokumentacionit në procesin e lëshimit, ripërtëritjes të certifikatave të autorizim marketingut, vlerësimin të variacioneve si dhe aktivitetet e Farmakovigjilencës me referencë të veçantë për aktivitetet e menaxhimit të rrezikut, aktivitetet e licencimit të veprimtarive, lejeve të importit, analizat laboratorike të kontrollit cilësisë.

Indikatorët bazë të performancës

- 651 leje për importin e produkteve medicinale;
- 801 aplikime për autorizim marketingu;
- 1,532 leje për importin e pajisjeve medicinale;
- 13 qarkullues me shumicë të produkteve dhe pajisjeve medicinale;
- 10 qarkullues me shumicë të pajisjeve;
- 22 qarkullues me pakicë të produkteve medicinale;
- 12 operues më narkotikë, psikotropë dhe perkursorë;
- 76 autorizime për terapi individuale.

4. Pasqyra e performancës financiare

Ministria e Shëndetësisë ka barazuar gjendjen fizike me atë elektronike të transaksioneve për muajt korrik-shtator me programet vartëse dhe programet tjera brenda Ministrisë. Është bërë raportimi i obligimeve dhe kontratave aktive sipas kërkesës së Ministrisë së financave punës dhe transfereve. Ministria e Shëndetësisë për vitin 2024 sipas Ligjit të Buxhetit ka buxhet në vlerë prej 83,488,684.10 €. Në tërësi gjatë vitit 2024 janë shpenzuar 36,658,691.87.€ apo 43.91% e buxhetit. Në tabelën e mëposhtem është paraqitur pasqyra e buxhetit për tremujorin e tretë të vitit 2024.

Përshkrimi	Buxheti i përgjithshëm	Buxheti aktual	% e Shpenzimit
11 PAGA DHE SHTESA	14,741,932.13	11,911,093.53	80.80%
13 MALLRA DHE SHËRBIME	29,837,821.63	15,474,463.94	51.86%
14 SHPENZIME KOMUNALE	288,848.00	178,238.44	61.71%
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	3,613,805.00	2,286,315.26	63.27%
30 PASURITË JOFINANCIARE	35,006,277.34	6,808,580.70	19.45%
Totali i Përgjithshëm	83,488,684.10	36,658,691.87	43.91%

Tabela Nr. 1. Shpenzimet totale në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë

4.1 Shpenzimet kapitale, projektet dhe prokurimi

Investimet kapitale në vitin 2024 janë kryesisht vazhdimësi e projekteve nga vitet e kaluara të cilat nuk kanë mundur të fillojnë me kohë si rrjedhojë e projekteve të mangëta dhe jo profesionale. Gjithsesi Ministria me qëllim të ngritjes së nivelit të shfrytëzimit të mjeteve për investime kapitale ka ndërmarrë hapat e nevojshme që projektet kapitale të parapara për vitin 2024 dhe mjetet e ndara financiare për këtë qëllim të shfrytëzohen maksimalisht dhe brenda afatit të përcaktuar.

Indikatorët bazë të performancës

- Vazhdim i Ndërtimit - Qendra e mjekësisë emergjente ne QKUK - sipas vendimit të OSHP-së Nr. 0352 te datës 11.09.2024, lënda është kthyer në rivlerësim;
- Mbikëqyrja profesionale e ndërtimit te QKMF ne Istog dhe QKMF ne Drenas - për llot 2-mbikëqyrja e QKMF Drenas, lënda është e pezulluar për shkak të një ankese në OSHP në pritje të vendimit nga OSHP, ndërsa është nënshkruar kontrata për llot 1-mbikëqyrja e QKMF Istog;
- Ndërtimi i QKMF në Istog- është pezulluar realizimi i kontratës deri në lirim të hapësirave, dhënia e lejes për rrenim te objekteve ekzistuese nga komuna;
- Ndërtimi i QKMF në Drenas- është konfirmuar pajtueshmëria me ekspertizën dhe presim vendimin e OSHP-se;
- Ndërtimi i QKMF në Shtime pritet aplikimi për leje ndërtimore në Komunën e Shtimes dhe rishikimi buxhetor-mjetet shtesë për tenderimin e punëve;
- Ndërtimi i Institutit Special në Shtime - pritet ri-aplikimi për leje ndërtimore në Komunën e Shtimes;
- Ri-projektimi i Spitalit te përgjithshëm të Ferizajt - është dorëzuar projekti te hënën me datë 07.10.2024;
- Furnizimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemit Packs dhe RIS të SISH pritet vendimi nga OSHP, janë dhënë tri (3) ekspertiza, dy në favor të MSh, e njëra në favor të OE për rivlerësim;
- Hartimi i projektit për adaptimin e objektit të Depos së barnave janë kërkuar disa plotësime në projekt, pritet që komisioni të hartoj raportin e pranimit te projektit zbatues;
- Furnizim me autoambulanca pritet hapja e ofertave me datën. 10.10.2024

- Ri-tender furnizim me pajisje për laboratorët mikrobiologjik në IKSHPK (Lot 1) është formuar komisioni i vlerësimit të ofertave dhe pritet vlerësimi;
- Renovimi i objekteve ekzistuese te Instituti special në Shtime është shpallur fituesi dhe pritet nënshkrimi i kontratës;
- Ndërtimi i Depos se barnave për Spitalin e përgjithshëm në Mitrovicë është shpallur fituesi dhe pritet nënshkrimi i kontratës;
- Furnizim me pajisje mjekësore dhe inventar medicinal për Poliklinikën ne Podujevë - janë shpallur fituesit për tri llojet dhe pritet nënshkrimi i kontratave;
- 31 aktivitetet të prokurimit të publikuara;
- 22 kontrata të prokurimit të nënshkruara.

5. Zbatimi i rekomandimeve të Zyrës kombëtare të auditimit dhe të njësisë së brendshme të auditimit

Për periudhën raportuese, nga Njësia e auditimit të brendshëm është vazhduar me aktivitetet të cilat janë në kuadër të planit vjetor përfshi dhe angazhimet sipas kërkesës së menaxhmentit. Janë përfunduar dy raporte dhe sipas të gjeturave janë dhënë 9 rekomandime për të mbështetur menaxhmentin rreth përgjegjësi të tyre për efikasitetin dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Referuar në përcaktimet e menaxherëve sipas planit të veprimit dhe afateve për zbatim do të ketë monitorim periodik të progresit në zbatimin e rekomandimeve.

Indikatorët bazë të performancës

- Menaxhimi i kontratave në IKShPK të audituara;
- Menaxhimi i aktiviteteve dhe shpenzimi i parasë publike në ISSH dhe SHF të audituara;
- Procesi mbështetja e OJQ-ve për projekte me fokus në fushën e shëndetësisë i audituar.

5.1. Zbatimi i rekomandimeve të Zyrës kombëtare të auditimit për PVF 2022

Raporti i Zyrës kombëtare të auditimit për pasqyrat vjetore financiare 2023 të Ministrisë së Shëndetësisë ka evidentuar gjashtë (6) të gjetura. Ministria nuk është pajtuar për dy të gjetura. Për adresimin e këtyre të gjeturave dhe adresimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra kombëtare të auditimit (ZKA), Ministria në vitin 2024 ka hartuar planin për zbatimin e rekomandimeve të ZKA për pasqyrat vjetore financiare të Ministrisë së Shëndetësisë për vitin 2023.

Indikatorët bazë të performancës

- Një (1) rekomandim i zbatuar;
- Tri (3) rekomandime në process të zbatimit.

5.2. Zbatimi i rekomandimeve të Zyrës së Avokatit të popullit

Sa i përket zbatimit të rekomandimeve të Zyrës së Avokatit të popullit, gjatë kësaj periudhe është shqyrtuar raporti nga Komiteti për Parandalimin e Torturës (CPT) i Këshillit të Evropës pas vizitës së realizuar në tetor të vitit 2020. Ministria ka adresuar rekomandimet e dala nga raporti në institucionet relevante dhe përgjigjet e pranuar janë përcjellë Zyrës së Avokatit të popullit.

5. Planet për tremujorin e ardhshëm

Ministria e Shëndetësisë në tremujorin e katërt të 2024 synon të zbatoj aktivitetet në kuadër të objektivave strategjike të përcaktuar me Planin kombëtar për zhvillim 2024-2026 dhe Planin kombëtar për integrim Evropian 2024-2026. Gjatë këtij tremujori do të hartohen dhe finalizohen plani kombëtar për zhvillim 2025-2027 dhe plani kombëtar për integrim Evropian 2025-2027.

Në kuadër të riorganizimit të sektorit të shëndetësisë parashihet vazhdimi i plotësimit të kornizës ligjore, hartimi i politikave afatgjate, hartimi i standardeve, fuqizimi i kapaciteteve monitoruese, vazhdimi i zhvillimit të kujdesit aplikativ dhe sistemit të informimit shëndetësor. Ministrisë së Shëndetësisë, do të vazhdoj procesin për sistematizimin e vendeve të punës sipas rregullores rregullores së brendshme, ku rolet dhe përgjegjësitë sipas strukturës së re do të reflektojnë mbulimin e të gjitha përgjegjësiave aktuale dhe përgjegjësiave të reja.

Sa i përket ruajtjes dhe përparimit të shëndetit gjatë tremujorit të tretë 2024 fokusi, do të vihet në shëndetin publik, grupet e cënueshme, avancimin e konceptit të mjekësisë familjare, miratimin e planeve për skринing dhe ngritjen e bashkëpunimit regional në shëndetësi si dhe përcaktimin e standardeve për sigurim të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore;

Për të siguruar financimin e qëndrueshëm në shëndetësi gjatë tremujorit të katërt parashihet të plotësohet korniza ligjore për sigurim shëndetësor dhe zhvillimi i aktiviteteve për fuqizimin e kapaciteteve të fondit të sigurimit shëndetësor;

Një ndër prioritetet bazë do të jetë edhe furnizimi i vazhdueshëm dhe qëndrueshëm i KPSH me kërkesa të rregullta dhe emergjente për barna dhe material shpenzues.

6. Sfidat

- Nivel jo i kënaqshëm i zbatimit të Planit Kombëtar për Zhvillim dhe integrim evropian;
- Mungesa e Strategjisë Sektoriale Shëndetësore;
- Niveli i ulët i hartimit dhe finalizimit të Udhërrëfyesve klinikë dhe protokolleve klinike;
- Vonesat në vendim-marrje nga OSHP që ndikon në nivel të ultë të zbatimit të projekteve kapitale;